



## WORCESTER PUBLIC SCHOOLS

Office of the Superintendent  
Dr. Rachel Monárrez  
Superintendent

**P** 508-799-3115  
**F** 508-799-3199  
**E** [communications@worcesterschools.net](mailto:communications@worcesterschools.net)

Dr. John E. Durkin  
Administration Building  
20 Irving Street  
Worcester, MA 01609-2493

Mars 2023

Mirëdita, Kujdestarë të Shkollave Publike të Worcester-it:

Është e vështirë të besohet por jemi në muajin e shtatë të vitit shkollor 2022-23 dhe tashmë kemi festuar ditën e 100<sup>te</sup> të shkollës. Unë sinqerisht shpresoj që fëmijët tuaj dhe e gjithë familja të kenë një përvojë shkollore pozitive të mbushur me mundësi të shumta për të zgjeruar të menduarit, për të zbuluar koncepte të reja, për të bërë shokë të rinj dhe për të ndikuar pozitivisht tek ata përreth jush. Unë vazhdoj të jem mirënjohës për mundësinë për të udhëhequr Shkollat Publike të Worcester-it.

Qëllimi i kësaj letre është të përgëzojë një sërë arritjesh në WPS, të ofrojë një përditësim të statusit nga turneu im i dëgjimit dhe mësimin dhe të ndajë kush duhet të jenë pritshmëritë tuaja dhe si të qëndroni të angazhuar duke ecur përpara.

### **Përgëzimet:**

- **Pikat Kryesore të Veprimtarive të Nxënësve:** Nxënësit tanë vazhdojnë të bëjnë përshtypje me talentet dhe aftësitë e tyre të shumta dhe mbresëlënëse. WPS është shtëpia e studiuesve, atletëve, artistëve, shkencëtarëve dhe muzikantëve të talentuar dhe sensacionalë, dhe më shumë!

**Skuadra e futbollit e South High** dhe **skuadra e hokejit në fushë e Doherty** shkuan thellë në playoff pas sezoneve shumë të suksesshme. **Ekipi i kërcimit të Burncoat** shkoi në turneun kombëtar dhe ishin gjysmëfinalistë të turnet kombëtar, dhe 30 nxënës të Shkollave Publike Worcester u pranuan në Festivalin e Muzikës Junior nga shkollat **South, Burncoat dhe Sullivan**. Për më tepër, nxënësit tanë të talentuar dërguan mbi 1000 aplikime në konkursin e 45-të Vjetor të **Shoqërisë Historike Worcester "Bëhu Shën Valentini im"**.

Nëse keni menduar ndonjëherë për shkëlqimin e nxënësve tanë, ndiqni WGBH dhe shikoni **South High** të konkurrojë në shfaqjen shumë konkurruese të **Kuizit të Shkollës**

së Mesme. ([Shikoni episodin online!](#))

**Shkollat e Mesme Doherty dhe South High** përfaqësuan me krenari Shkollat Publike Worcester dhe morën pjesë në Turneun **High School VEX Robotics** në Shkollën Bancroft.

Dhe së fundi, ekipet tona të sporteve të dimrit: **Basketbolli i djemve të North** dhe **basketbolli i vajzave të South** janë dy skuadrat më të mira në rajon për t'u parë! Qoftë në klasë, në fushë apo në pallatin e sportit, duke performuar apo duke ndërtuar robotë, nxënësit e shkollave publike Worcester mund t'i bëjnë të gjitha.

- **Përmirësimet e Sigurisë:** Ne kemi kontraktuar me *Guidepost Solutions* për të kryer një auditim sigurie të objekteve të distriktit tonë. Ne parashikojmë të marrim rekomandime për përmirësime në fushat e masave të sigurisë fizike (bravat e dyerve, kamerat, ndriçimi i jashtëm, kontrollet e aksesit), procedurat e mbërritjes dhe largimit nga shkolla, stërvitjet dhe ushtrimet e sigurisë së nxënësve dhe stafit. Për më tepër, të gjithë drejtorët e shkollave, administratorët e nivelit të qarkut dhe anëtarët e Departamentit të Policisë së Worcester-it përfunduan një trajnim njëditor me “I Love You Guys”. Ju duhet të prisni të mësoni më shumë rreth “I Love You Guys” në të ardhmen, duke përfshirë opsionet për të ndjekur një seminar për kujdestarët. [www.iloveyouguys.org](http://www.iloveyouguys.org)
- **Suport i Përmirësuar për Familjet dhe Nxënësit:** Me mbështetjen e Komitetit të Shkollës ne mundëm të punësonim në pozita kyçe për të mbështetur nxënësit dhe familjet. Ju duhet të prisni të shihni një komunikim të përmirësuar me familjet, duke përfshirë praninë e përmirësuar në mediat sociale dhe mënyra të tjera komunikimi nga shkollat dhe zyrat e distriktit. Për më tepër, ne synojmë të përmirësojmë angazhimin e familjes dhe kemi punësuar njerëz për të ndihmuar në udhëheqjen e kësaj pune të rëndësishme. Së fundi, ne kemi kontraktuar me ofruesit lokalë për të mbështetur nevojat e shëndetit mendor të të rinjve tanë në shkollat tona tetëvjeçare dhe të mesme.

#### **Temat e Turneut të Dëgjimit dhe Mësimi:**

Faleminderit atyre që mundën të gjenin kohën nga oraret e tyre të ngjeshur dhe të merrnin pjesë në një forum dëgjimi vjeshtë e kaluar ose të japin të dhëna përmes sondazhit dixhital.

Temat e mëposhtme u shfaqën nga ajo që ju ndatë:

1. Objekte të Modernizuara dhe të Sigurta
2. Klima dhe Kultura e Shkollës
3. Komunikimi & Angazhimi i Vazhdueshëm
4. Mirëqënia & Shëndeti Mendor
5. Resurse të Barabarta dhe Programe Edukative
6. Fitimi dhe Mbajtja e Talentit

**Pra, Cfarë Vjen më Pas?**

1. Avancimi i Planit Strategjik ekzistues përmes përfshirjes së temave nga forumet e dëgjimit dhe të dhënave që kam mbledhur gjatë vizitave në klasa.
2. Mbledhja e një grupi palësh të ndryshme të interesuara për të avancuar planin strategjik.
3. Përvijimi i standardeve, matjeve dhe alokimeve fiskale brenda planit strategjik të pasuruar për të monitoruar dhe siguruar ndikimin në mësimin e nxënësve.
4. Lançimi i Planit Strategjik të pasuruar Shtator 2024.
5. Zbatoni rekomandimet e auditimit të sigurisë, duke përfshirë alokimet buxhetore, sipas nevojës.
6. Vazhdimi i kërkimit të metodave për të qëndruar të lidhur/angazhuar me shkollat, familjet dhe partnerët e komunitetit.


### **Si mund të qëndroni të informuar dhe të angazhuar?**

- Sigurohuni që të ndiqni WPS në faqet e [Facebook](#), [Twitter](#), dhe [Instagram](#) të tyre për të qëndruar të azhurnuar me atë që po ndodh në shkollat tona!
- Për të gjetur përditësime mbi formimin e Planit Strategjik, vizitoni [worcesterschools.net/planupdates](http://worcesterschools.net/planupdates). Së shpejti do të publikojmë informacione këtu.

Unë vazhdoj të besoj në mundësinë e Shkollave Publike Worcester. Ne jemi një grup i përkushtuar individësh që jemi këtu për t'i shërbyer këtij komuniteti të madh të Worcester-it. Së bashku me ju, Komitetin tonë të Shkollës dhe partnerët tanë të komunitetit nuk ka asgjë që nuk mund dhe nuk do të arrijmë.

Ju lutemi vazhdoni të mbështetni, veproni me guxim, injoroni zhurmën dhe qëndroni të përqendruar në qëllimin tonë të ekzistencës – edukimin e brezave të ardhshëm. Nga këtu, kudo... së bashku.

Sinqerisht,



Rachel H. Monárrez, Ph.D.  
Superintendent e Shkollave